

VENDIM
Nr. 687, datë 26.10.2022

**PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË SPITALIT
RAJONAL “MEMORIAL” NË FIER, SI APLIKUES I AUTONOMISË SPITALORE
MENAXHERIALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 55/2022, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Funksionimin e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, si projekt pilot me status të veçantë si spital i nivelit terciar.

2. Spitali Rajonal “Memorial” në Fier ushtron veprimtarinë e tij në bazë të legjislacionit në fushën e shërbimit spitalor dhe bazuar në marrëveshjen e lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, të ratifikuar me ligjin nr. 23/2021, me seli në Fier, pjesë e skemës së sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor.

3. Spitali Rajonal “Memorial” në Fier aplikon autonominë menaxheriale, si një spital pilot për një periudhë 2-vjeçare, sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë autonominë spitalore menaxheriale.

4. Ministri përgjegjës për shëndetësinë pajis spitalin “Memorial” në Fier me Kartën e Autonomisë Menaxheriale për një periudhë 2-vjeçare, e cila mirëpërcakton fushat në të cilën aplikohet autonomia menaxheriale.

5. Spitali Rajonal “Memorial” në Fier do të funksionojë për një periudhë tranzitore në bashkëpunim me personat e caktuar nga ministria e shëndetësisë turke, sipas protokollit të bashkëpunimit të lidhur ndërmjet dy ministrave përkatës, përgjegjës për shëndetësinë, i miratuar me vendimin nr. 58, datë 26.1.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal ‘Memorial’ në Fier, gjatë fazës kalimtare”.

6. Spitali Rajonal “Memorial” në Fier ofron shërbimet bazë, sipas listës së shërbimeve të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

7. Spitali Rajonal “Memorial” në Fier e ushtron veprimtarinë e tij, në përputhje me standardet, treguesit e cilësisë e të performancës, protokollat e diagnozës e të trajtimit, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

8. Rregullimet e përgjithshme dhe në hollësi të veprimtarisë së Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier përcaktohen në statutin e spitalit, i cili miratohet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.

9. Organet drejtuese të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, i pajisur me Kartën e Autonomisë Menaxheriale, janë:

- a) Bordi Drejtues;
- b) Ekipi menaxhues;
- c) Administratori i Përgjithshëm.

10. Bordi Drejtues është organi kolegjial më i lartë drejtues i spitalit publik autonom dhe është i pavarur në veprimtarinë e tij. Përbërja dhe funksionet e bordit përcaktohen në rregulloren e autonomisë spitalore.

11. Ekipi menaxhues i spitalit autonom përbëhet nga administratori i Përgjithshëm, drejtuesit teknikë dhe ekonomikë. Detyrat e ekipit menaxhues përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të spitalit.

12. Administratori i Përgjithshëm i spitalit është autoriteti më i lartë ekzekutiv i spitalit autonom dhe emërohet nga Bordi Drejtues sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e autonomisë spitalore. Detyrat e administratorit të Përgjithshëm përcaktohen në rregulloren e brendshme të funksionimit të spitalit.

13. Anëtarët e bordit marrin shpërblim për pjesëmarrje në mbledhje, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore.

14. Bordi Drejtues raporton periodikisht pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

15. Financimi nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor realizohet sipas paketave të shërbimeve spitalore, në përputhje me listën e shërbimeve të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

16. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidh kontratë me Spitalin Rajonal “Memorial” në Fier për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore, duke përfshirë shpenzimet për personelin, shërbimet korrente dhe paketat e shërbimeve të ofruara dhe kontrollon e monitoron buxhetin spitalor, aktivitetin vjetor të spitalit, bazuar në indikatorët e performancës, nëpërmjet strukturave të tyre audituese e kontrolluese, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

17. Të ardhurat dytësore, të realizuara nga Spitali Rajonal “Memorial” në Fier, përdoren nga vetë spitali, sipas kriterëve që përcaktohen në statut dhe miratohen nga Bordi Drejtues i spitalit.

18. Struktura dhe organika e spitalit miratohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, me propozimin e Bordit Drejtues të spitalit.

19. Personeli i kujdesit shëndetësor turk caktohet nga Republika e Turqisë gjatë fazës së transicionit të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, në zbatim të nenit 1, të marrëveshjes së lidhur, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë, ratifikuar me ligjin nr. 23/2021.

20. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të spitalit rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

21. Institucionet kompetente ushtrojnë kontroll mbi veprimtarinë e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, sipas legjislacionit në fuqi dhe brenda fushës së tyre të përgjegjësisë.

22. Spitali Rajonal “Memorial” në Fier ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë; Spitali Rajonal “Memorial” në Fier, në përputhje me përcaktimet e vendimit të Këshillit të Ministrave për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës së Shqipërisë.

23. Vendimi nr. 175, datë 17.3.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen, organizimin dhe funksionimin e Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, si projekt pilot”, i ndryshuar, shfuqizohet.

24. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të pikave 3 dhe 4, të këtij vendimi, që hyjnë në fuqi më 1 janar 2023.

KRYEMINISTËR
Edi Rama